



KB

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
KRYETARI

Nr. 2402 prot.

Vlorë, më 18.02 2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, Datë, _____ 2025

"PËR KRIJIMINI KËSHILLIT ARTISTIKO - KULTUROR DHE SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË TIJ"

Bazuar në Nenin 8, pika 2, Neni 9, pika 1/1.1 shkronja "d", Nenin 25, pikat 2 dhe 4, Neni 54, shkronja "ç" dhe Neni 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"; në Ligjin Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", (i ndryshuar), në Ligjin Nr. 10352, datë 18.11.2010 "Për artin dhe Kulturën", në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 540, datë 21.12.1992 për "Krijimin e Këshillave Artistiko - Kulturor dhe shpërblimin e anëtarëve të tyre" i ndryshuar me Vendimin Nr. 121, datë 25.02.2005, në VKB-në me Nr. 111, datë 27.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2025" si edhe në Relacionin e paraqitur nga administrata e Bashkisë Vlorë, "Për Krijimin e Këshillave Artistiko - Kulturor dhe për shpërblimin e anëtarëve të tyre",

V E N D O S I:

- Të miratojë përbërjen e Këshillit Artistiko-Kulturor, i përbërë nga 5 (pesë) anëtarë si më poshtë:
 - Vasil Çuni Mësues, Mjeshtër Kori, Krijues si orkestrees dhe dirigjent
 - Roland Runaj Piktör
 - Myrteza Mara Shkrimtar
 - Kozma Billa Poet
 - Zamira Agalliu Poete publicist, eseiste
- Mandati i anëtarëve të Këshillit Artistiko-Kulturor do të jetë dy vjeçar.
- Pagesa për çdo anëtar të Këshillit Artistiko-Kulturor do të jetë shuma e përcaktuar sipas pikës 4 të Vendimit Nr. 121, datë 25.02.2005 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 540, datë 21.12.1992 të Këshillit të Ministrave", vetëm në rastet kur do të zhvillojnë

mbledhjet gjatë muajit, shpenzim ky që do të përballohet nga fondet e buxhetit të Bashkisë Vlorë për projektet kulturore.

4. Për zbatimin e këtij Projekt-Vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit

Ky Projekt - Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Ermal Dredha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 2402 prot.

Vlorë, më 18.02.2025

RELACION

Mbi Projekt-Vendimin "PËR KRIJIMINI KËSHILLIT ARTISTIKO -
KULTUROR DHE SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË TIJ"

Para Këshillit të Bashkisë Vlorë

Të nderuar Këshilltarë!

Projekt-Vendimi, "PËR KRIJIMINI KËSHILLIT ARTISTIKO - KULTUROR DHE SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË TIJ" pranë institucionit të Bashkisë Vlorë mund të ketë shumë përfitime për zhvillimin kulturor dhe artistik të qytetit. Ky këshill artistiko-kulturor mund të shërbejë si një platformë për të mbështetur artistët lokal, për të pasuruar jetën kulturore dhe për të promovuar Vlorën si një destinacion têrheqës për turizmin kulturor.

Arsyet për krijimin e këshillit artistiko-kulturor:

- Mbështetje për artistët lokalë:** Grupi mund të ofrojë mundësi për artistët e rinj dhe ata aktualë që të zhvillojnë dhe ekspozojnë punimet e tyre në një mjedis institucional. Një mbështetje e tillë mund të përfshijë organizimin e aktiviteteve, ekspozitave dhe performanca artistike.
- Rritja e angazhimit qytetar:** Aktivite kulturore mund të nxisin angazhimin e qytetarëve të Vlorës, duke krijuar mundësi për t'u përfshirë në aktivitete artistike dhe kulturore. Ky mund të jetë një hap për ndërtimin e një komuniteti aktiv dhe të përfshirë në jetën qytetare.
- Zhvillimi i turizmit-kulturor:** Krijimi i aktiviteteve artistike dhe kulturore mund të têrheqë turistët, duke i ofruar atyre një përvojë të pasur dhe autentike të qytetit të Vlorës.
- Rritja e bashkëpunimit me institucionet e tjera:** Bashkia mund të krijojë mundësi për bashkëpunim me institucione kulturore, shkolla, universitete dhe organizata jo-qeveritare për të mbështetur zhvillimin e artit dhe kulturës. Ky bashkëpunim mund të sjellë mundësi të reja për financime dhe resurseve.

Gjithashtu, ky Projekt-Vendim lidhet edhe me parashikimet e Ligjit Nr.10352 datë 18.11.2010 "Për Artin dhe Kulturën", i ndryshuar si dhe në VKM Nr.540, datë 21.12.1992 "Për krijimin e Këshillave Artistiko-Kulturore dhe për shpërblimin e anëtarëve të tyre", i ndryshuar. Sipas këtij Ligji, krahas institucioneve qëndrore të cilat i nështrohen dispozitave ligjore të mësipërme dhe organet e qeverisjes vendore duhet të punojnë për të nxitur zhvillimin e artit, si krijimi i shpirtërore; ruajtjen e identitetit kulturor kombëtar, nëpërmjet studimit, edukimit, prodhimit, paraqitjes dhe shpërndarjes së veprave artistike e kulturore; eksperimentimin e formave të reja të shprehjes skenike; realizimin e veprave artistike të autorëve shqiptare dhe të huaj, për të gjitha grupet e shtresat sociale; shkëmbimet teatrore ndërkombëtare, turnetë, festivalet, manifestimet intelektuale, riprodhimin audioviziv dhe botimet në fusha të ndryshme .

Referuar VKM-së të sipërcituar në këtë Projekt-Vendim është parashikuar krijimi i Këshillit artistiko-kulturore i cili duhet të ketë në përbërje personalitete të shquara në fushën e artit, të kulturës, të cilët do të propozojnë dhe janë mendime për hartimin dhe zbatimin e politikave kulturore e artistike pranë institucionit të Bashkisë Vlorë ku do të funksionojnë , dhe kohëzgjatja e mandatit si dhe mënyra e shpërblimit të tyre, që duhet të miratohen nga Këshilli i Bashkisë Vlorë.

Emrat e propozuar për krijimin e Këshilli Artistiko-Kulturore janë si më poshtë:

Vasil Çuni- me një kontribut shumëfishtë : Si një mësues , mjeshtër kori ,si krijues, si orkestrues dhe si dirigjent dhe të gjitha kanë rezultuar të sukseshme dhe frytdhënëse. Krijimtaria e tij ka shtrirje në shumë qytete të tjera si në: Shkodër, Elbasan, Fier, Durrës, Tepelenë, Gjirokastër, duke përfshirë këtu tablotë muzikore për fëmijë, të rritur në konkurrimin e shkollave te mesme, suitën për Orkestrën e Madhe Simfonike , këto veprimtari janë dalluar për një cilësi të lartë ekzekutimi.

Roland Runaj - Ka kryer studimet fillore pranë shkollës 8-vjecare “Teli Ndini”.Gjatë gjithë këtyre viteve vazhdon të frekuentojë rregullisht kursin e pikturës pranë Shtëpisë së pionerit “Bajram Fejzo” në qytetin e Vlorës . Në 1992 ka konkuruar në degën pikture dhe fillon studimet pranë Liceut Artistik të qytetit “Naim Frashëri” . Diplomohet në vitin 1996. Më pas emigron në Itali dhe në vitin 2001 regjistrohet pranë Akademisë së Arteve të Bukura në Lecce në degën pikture. Laureohet në vitin 2006 me 110/lode dhe në 2008 vazhdon studimet pasakademike me specializim dy vjecar (doktoraturë , 4+2) dhe në 2010 laureohet me 110/lode . Vazhdon karrierën artistike duke marrë pjesë në shumë ekspozita e premio kombëtare dhe ndërkombëtare

Myrteza Mara - Ushtarak karriere me specialitet kimi. Arsimit:

- Shkolla e mesme dhe e lartë ushtarake ,
- Akademia Ushtarake
- Kolonel në lirim

Dalë në lirim sipas reformës Ushtarakë në vitin 1992 me gradën Kolonel. Nismëtar dhe drejtues i Shoqatës (Klubit) të Poetëve dhe Shkrimtarëve “Petro Marko” Vlorë në vitin 1998, në fillim sekretar dhe më pas kryetar. Në Shkurt 2006 zgjidhet Kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve, Dega Vlorë dhe anëtar i Kryesisë së Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë. Rizgjidhet Kryetar i Shoqatës “Petro Marko” Prill 2009- Tetor 2010 dhe ka organizuar

shëndrrimin e Shoqatës në "Klub i shkrimëtarëve "Petro Marko". Autor i 13 vëllimeve me Poezi dhe tetë në Prozë.

Kozma Billa- Ka përfunduar shkollën 7-vjeçare në fshatin e lindjes dhe në vitin 1964 ka nisur gjimnazin "Halim Xhelo" Vlorë dhe e ka përfunduar në vitin 1968. Gjatë kësaj periudhe, përveçse ka qënë anëtar i rrëthit letra të shkollës, i aktivizuar edhe në teatrin e shkollës dhe në veprimitari të ndryshme kulturore e artistike. Në vitin 1968 është regjistruar në Institutin Pedagogjik të Shkodrës në degën Gjuhë shqipe dhe letërsi, të cilën e përfundoji në vitin 1970. Gjatë kësaj kohe është marrë me shkrime letrare, duke qenë Kryetar i Rrëthit Letrar të institutit, ka marrë pjesë në festivalin e 11-të kombëtar të këngës për fëmijë me tekstin "Unë pianisja e vogël" si dhe në festivalin për fëmije, po në Shkodër. Në Shkodër ka qenë redaktor letrar i teksteve të festivalit të 10 dhe të 11 për fëmijë. Në vitin 1969 ka qenë drejtues dhe organizator i spektaklit me studentët me rastin e 25-vjetorit të çlirimt të atdheut. Ka qenë anëtar i Klubit kulturor "Heronjtë e Vigut" në Shkodër, ku ka botuar në almanakun e këtij klubi "Shtigje të çelura" poezi të ndryshme në numrat e tij, si edhe në almanakun "Shkodra" në vitin 1969", si dhe në gazeten lokale "Jeta e re".

Zamira Agalliu- është një poete publiciste, eseiste që ka filluar të shkruaj që në moshën 12 vjecare. Ka botuar vëllime me poezi: - "Zemëruar me Apostujt" - "Mall i Arratisur" - "Zjarri i Erës" - Eni Camaroku - Jam aty. Ka kryer studimet e larta dhe Master Profesionale në UV Ismail Qemali Vlorë Dega Shkenca Humane. E licensuar për Mësuesi me vlerësim maksimal. Është vlerësuar gjithashtu me cmime e certifikata vlerësimi nga Klube letrare brenda dhe jashtë vendit. Shkrimet e saj me tema sociale dhe historike janë një kontribut i veçantë për kultuvimin e kulturës qytetare dhe asaj patriotike.

Miratimi i këtij Projekt -Vendimi nga ana juaj dhe krijimi i Këshillit Artistiko-Kulturor i Bashkisë Vlorë , vlerësojmë se janë të domosdoshme për të realizuar sa më mirë çështjet artistiko-kulturore në qytetin e Vlorës , për të nxitur zhvillimin e artit dhe ruajtjen e identitetit kulturor kombëtar .

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Dorian Demiri



CIVI=Myrteza Mara

MYRTEZA ZOTO MARA

- Lindur në Peshkëpi-Vlorë, 29.01.1943
- Banues në Vlorë.
- Ushtarak karriere me specialitet KIMI.
- Arsimimi:

- Shkolla e mesme dhe e lartë ushtarake
- Akademia Ushtarake
- Kolonel në lirim

Medalja “Ylli i Kuq”, “Urdhër i Shërbimit Ushtarak kl.1,2”

“Mirënjohje e Qytetit të Vlorës”
“Qytetar Nderi” i Komunës Vllahinë-Vlorë
“Mirënjohje e Qarkut Vlorë”
“Nderi i Skollës” “Dëshmorët e fshatit Peshkëpi”
“Anëtar i Akademisë Europiane të Arteve ”

- Dalë në lirim sipas reformës Ushtarake në vitin 1992 me gradën Kolonel.
- Nismëtar dhe drejtues i Shoqatës (Klubit) të Poetëve dhe Shkrimtarëve “Petro Marko” Vlorë në vitin 1998, në fillim sekretar dhe më pas Kryetar.
- Emigracion në Itali në vitin 1999-2002.
- Shkurt 2006 zgjidhet Kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve, Dega Vlorë dhe anëtar i Kryesisë së Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë.
- Rizgjidhet Kryetar i Shoqatës “Petro Marko” Prill 2009.
- Tetor 2010 organizon shndrrimin e Shoqatës në “Klub i Shkrimtarëve “Petro Marko”.
- Autor i 13 vëllimeve me Poezi dhe tetë në Prozë.

-ÇMIME-

- Çmimi “Çift&Harmoni” nga gazeta “Horoskop” për San Valentino-2005
- Penda e Artë-nga Klubi “Drita” Athinë-.....2006
- Çmimi i dytë në Konkursin Kombëtar “Poezi për Detin” -Durrës 2006
- Çmimi i tretë në Konkursin Kombëtar..... -Lushnjë 2007
- Çmimi i Parë në Festivalin Poetik Ballkanik.....-Korçë 2010
- Çmimi “Korça” Festivali Netët e Poezisë Korçare-Korçë 2011

- Çmimi “Ali Asllani” si liriku më i mirë i viti 2009..... -Athinë 2010
- Çmimi i Dytë në Konkursin “Drita e Minatorit”-Mitrovicë-Tetor 2012
- Çmimi i Dytë nga Bashkia Vlorë për Poezi.....Djetor 2012
- Çmimi “Mitrush Kuteli”-Klubi Drita Athinë për Novela e Tregime “Muzeu i Dhembjes” 2012
- Çmimi i Parë për vëllimin poetik “Stina e Pestë nga Biblioteka “Sh Musaraj” dhe Bashkia Vlorë”.....Dhjetor 2013
- Çmimi i Karierës.....Durrës, Maj 2014
- Çmimi“Shkrimtari i Vtit 2016”-shpallur nga Shtëpia Botuese KASKANIDIS-Athinë 2016 (Për botimin e romanit LISIANA”
- Çmimi i Tretë për poezi në Fsetivalin Europian të poezisë-Selanik 2017
- Çmimi “Frang Bardhi” 2018 dhënë nga bordi i revistës kulturore ATUNIS me qendër në Bruksel.
- Përfshirë në tre Antologji ndërkombëtare për poezi.
- Zgjidhet Kryetar i Këshillit Artistiko-Kulturor Bashkia Vlorë..Qershori 2014
- Përfshirë në katër Antalogji poetike si dhe në librin me kritika e vlerësime të Dr. Fatmir Terziut-2011
- Kanë referuar dhe publikuar mendime kritike në organe të ndryshme të shtypit Prof, Dr. Josif Papagjoni, Prof. Dr. Fatmir Terziu, Shkrimtari dhe poeti Thanas Jani, Fatime Kulli, Qerim Skënderaj, Raimonda Mojsiu, Xheladin Mjeku, Shpend Topallaj, Agim Bajrami, Gëzim Llojdja, Majlinda Rama, Përparim Hysi, Hqmet Hasko, etj.

Biznes: President i Firmës së Ndërtimit “MARA”- SH.P.K

KRIJIMTARIA

POEZI

1. Ku është Parajsa1997
2. Mëkatë i Botës.....1998
3. Nisje e Vonuar.....2000
4. Dielli i Puthjes (lirika).....2000
5. Në Portat e Iluzioneve.....2003
6. Dëshmitarja e Verbër.....2003
7. Kur do kthehet Dielli.....2004
8. Nën hijen e një ëndrre të bardhë..... 2005

9. Gjurmët e Heshtjes..... 2005
- 10.Qiriri i Perduar..... 2006
- 11.Sytë e Erës..... 2009
- 12.Stina e Pestë..... 2013
- 13.Nuk kam Kohë..... 2019

PROZË

1. Semaforët e Thyer-roman.....2007
2. Fají i Bukur (Lisiana)-novelë.....2008
3. Gruaja e një ëndrrë të bardhë-roman...2008
4. Dy dashuri-roman.....2009
5. Muzeu i Dhembjes-Novela, tregim2011
6. Dy amanete.....-Novela, tregime...2019
7. Monografi për babain (Zoto Mara).....2019
8. Ata janë në qiell...Novelë&tregime.....2023

Zamira Agalliu- është një poete publiciste, eseiste që ka filluar të shkruaj që në moshën 12 vjecare.

Ka botuar vëllime me poezi:

- "Zemëruar me Apostujt"
- "Mall i Arratisur"
- "Zjarri i Erës"
- Eni Camaroku
- Jam aty.

- Kreu studimet e larta dhe Master Profesionale në UV Ismail Qemali Vlorë Dega Shkenca Humane

- E Licensuar për Mësuesi me vlerësim maksimal.

- Është vleresuar gjithashtu me cmime e certificata vlerësimi nga Klube letrare brenda dhe jashtë vendit. Shkrimet e saj me tema sociale dhe historike janë një kontribut i veçantë për kultuvimin e kulturës qytetare dhe asaj patriotike.

Curriculum Vitae

Roland Runaj

Lindur ne Vlore me 18-08-1978 .Kryen studimet fillore prane shkolles 8-vjecare “Teli Ndini”.Gjate gjithe ketyre viteve vazhdon te frekuentoje rregullisht kursin e piktures prane Shtepise se pionerit “Bajram Fejzo” ne qytetin e Vlores . Ne 1992 konkuron ne degen pikture dhe fillon studimet prane Liceut Artistik te qytetit “Naim Frasher” .Diplomohet ne vitin 1996. Me pas emigron ne Itali dhe ne vitin 2001 regjistrohet prane Akademise se Arteve te Bukura ne Lecce ne degen pikture. Laureohet ne vitin 2006 me 110/lode dhe ne 2008 vazhdon studimet pasakademike me specializim dyvjecar (dotktorature , 4+2) dhe ne 2010 laureohet me 110/lode . Vazhdon karrieren artistike duke marre pjese ne shume ekspozita e premio kombetare dhe nderkombetare . Prej 13 vitesh drejton dhe kuron aktivitetet e Alpha Art Gallery dhe prej 4 vitesh ne Muradie Art Space ,kryesisht me aktivitete per artistet e rinj dhe bashkepunime me artiste vendas dhe te huaj .

Gjitheashtu kam specializim ne kompjuter grafik , pra te gjithe programet artistike te perpunimit grafik.

Ekspozita - Exhibitions

2020 Shih Detin

Promenade Gallery

Vlore

2019 Expo Art Tirana

Muzeu Historik

Tirane

2018 Vilson Kilica

Edicioni 3

Fier

Tirana Art Expo

M.H.K

Tirane

2017 Pranverart

M.H.K

Tirana

		BIENNALE DI TORINO
		International Art Prise
2016	The Fugitive	Vlore
	Under the stars	
	Hotel New York	Vlore
	Festa della Repubblica	Vlore
	Marina di Orikum	
	Vilson Kilica II Edition	
	Biblioteka	Fier
	Pranver Art	
	M.H.K	Tirana
	Expo Art Tirana	Tirana
	Realizem ndryshe	
	Retro Spirit	
	Teatri Petro Marko	Vlora
	Vilson Kilica II Edition	
	Biblioteka	Fier
2015	Imago Mundi	Tirana
	Beneton Collection	
	PranverArt	
	M.H.K	Tirana
	Tirana Art Expo	Tirana
	Vilson Kilica I Edition	
	Biblioteka	Fier
2014	Text'Ure	
	Solo show	Vlora

	Associazione Arte Citta Amica	Torino
	PRANVERART 5	
	Ekspozite kolektive	Tirana
2013	AUTUMN SALOON	Gjilan
	International Art Prise 9-th Edition	
2012	AUTUMN SALOON	
	International Art Prise 8- Edition	Gjilan
2011	Koloni Artistike	
	Ditet Vlonjate te piktures	
	Kuruar nga Piro Stefa	- Vlore
2010	LEAR 2010	
	Edward Lear Gallery	- Berat
	ONUFRI	
	Figurative Artists Association	- Skopje (MA)
	SALLONI VJESHTOR	
	International Art Prize	- Gjilan(KO)
	THE BERLIN WALL	
	Petro Marko Theater	- Vlore
	LABORATORIO ARTE E SCUOLE	

Due Popoli, un Mare ,un, Amicizia
Consolato Generale d'Italia a Valona

- Vlore

KOLOR VLONJAT
Diet vlonjate te piktures
Koloni artistike Monte Carlo Hotel

- Vlore

2008 CARROUSEL DU LOUVRE
Saloon Art Shoping
Arte Fiera al Carrousel Du Louvre

- Parigi

TRAME D'ARTISTA
percorso estetico di visioni contemporanee
PRIMAVERA IN ARTE
Concorso E.D.I.S. U Vincitore della sezione "Corti"
con l'opera "Metamorphosis"

- Lecce

- Lecce

2006 ITALIA - ALBANIA
Incontro nell' Arte Kuzum Baba

- Vlore

LE IMMAGINI - LA PAROLA
I giovani artisti dell'Accademia di Belle Arti e
l'Università di Lecce insieme per i prossimi 99 anni
Nuova sede dell' Rettorato

- Lecce

2005 UMANITA E NATURA
Premio Nazionale di Pittura "LUIGI BRAMANTI"
Comune di Castiglione d'Adda

- Milano

IL CAVALLETTO

Premio Nazionale di pittura

- Andrano

NATURARTE

Percorsi artistici nel territorio Lodigiano

- Milano

Premio Nazionale GAETANO MORGESE

Vincitore del Terzo Posto

Chiostro delle clarisse - Terlizzi

- Bari

CALENDARIO 2005

Acqueforti e disegni

Le vie di Lecce attraversate dall'inchiostro.

A cura di Glauco Lendaro

- Lecce

2004

WORK SHOP Comunicare un'idea con un segno

“Comunicazione visiva e l'arte di generare visioni”

La carta stampata invece della tela

A cura del maestro delle copertine Giancarlo

- Lecce

ARTE E GUSTO

Incontro con l'arte al ristorante

- Otranto

VISTI DA LONTANO

I Siciliani raccontati dagli altri

- Sicilia

IN LINEA a cura di Rita Tondo A.B.B.A - Lecce

2003 Collettiva al Castello Normano Svevo di Mesagne - Brindisi

CORPO A CORPO Castello di Carlo V - Lecce

KOZMA BILLA CV

Unë quhem Kozma Nikolla Billa. Kam lindur në fshatin Palasë më 25 korrik 1950.

Kam mbaruar shkollën 7-yjeçare në fshatin e lindjes dhe në vitin 1964 fillova gjimnazin "Halim Xhelo" Vlorë dhe e mbarova në vitin 1968. Gjatë kësaj periudhe, përveçse isha anëtar irretithet letra të shkollës, jam aktivizuar edhe në teatrin e shkollës dhe në veprimitari të ndryshme kulturore e artistike.

Në vitin 1968 regjistrohem në Institutin Pedagogjik të Shkodrës në degën Gjuhë shqipe dhe letërsi, të cilën e përfundova në vitin 1970. Gjatë kësaj kohe jam marrë me shkrime letrare, duke qenë kryetar i rrëthit letrar të institutit, kam marrë pjesë në festivalin e 11-të kombëtar të këngës për fëmijë me tekstin "Unë pianisja e vogël" si dhe në festivalin përfëmijë, po në Shkodër. Në Shkodër kam qenë redactor letrar i teksteve të festivalit të 10 dhe të 11 përfëmijë. Në vitin 1969 kam qenë drejtues dhe organizator i spektaklit me studentët me rastin e 25-vjetorit të çlirimit të atdheut. Kam qenë anëtar I Klubit kulturor "Heronjtë e Vigut" në Shkodër, ku kam botuar në almanakun e këtij klubi "Shtigje të çelura" poezi të ndryshme në numrat e tij, si edhe në almanakun "Shkodra" në vitin 1969, si dhe në gazetën locale "Jeta e re".

Gjatë praktikës pedagogjike në shkollën "Teli Ndini" Vlorë, maj 1970 përveç mësimdhënieς, organizova edhe një spektakël artistik

Pasi mbarova studimet u emërova në Skrapar, ku fillova punën si specialist kulture në Shtëpinë e Kulturës "Riza Cerova" Çorovodë.

Në vitin 1971 kreva një kurs kualifikimi 6-mujos si specialist culture (kulture massive).

Në Skrapar, përveç punës së përditëshme si organizator i punës kulturore, formave të ndryshme kulturore aktivitete madhore mund të pëmenden aktivitete të tilla, si dy koncerте madhore me rastin e 5 shtatorit, ditës së çlirimit të Skraparit, në rolin e Udhëheqësit artistik.

Në takimin e teatrove amatore organizuar në Skrapar në vitin 1971 me pjesëmarrjen e të gjitha vendeve të para ndër shtëpitë e Kulturës të qyteteve të Shqipërisë, si regjisori i vënies në skenë të dramës "Divorci" të autorit Ramiz Likaj, zë vendin e parë me të drejtën e paraqitjes në takimin tjetër në maj të vitit 1971 në qytetin e Elbasanit, ku zura vendin e tretë si trup dhe vendin e dytë si regjisori i dramës.

- Po në vitin 1971 në Çorovodë - Skrapar bëhem iniciatori i parë për të nxjerrë të parin almanak letrar në këtë qytet të titulluar "Tomori", në rolin e mbledhësit të materialit letrar, redaktorit dhe korrektorit letrar.

Përgatitja e koncertit qeveritar në vitin 1971 - Çorovodë

- Një ndër themeluesit e parë dhe redaktorët në gazetën e Skraparit "Jehona e Skraparit".

- Libretist i të gjitha veprimitarive të organizuara në Shtëpinë e Kulturës "Riza Cerova" Çorovodë, si dhe moderator dhe interpretues - Skrapar.

- Organizator, drejtues, moderator i shumë veprimitarive kulturore masivenë këtë institucion.

- Libretist, recitues, regjisori dhe drejtues si koncerti madhor në koncertin kushtuar Riza Cerovës.

- Pjesëmarrës i disa roleve si aktor në drama të ndryshme.

- Në vitin 1974 në një takim interpretuesh në bazë rrethi isha fitues i vendit të pare në gjithë rrëthin e Skraparit dhe mora pjesë në takimin kombëtar që u zhvillua në Tiranë, ku dola shumë mirë.

Gjithashtu në Skrapar, gjatë kohës që punova në Shtëpinë e kultures, punoja edhe si redaktor dhe korrektor i jashtëm në gazetën locale "Jehona e Skraparit": Në këtë periudhë

përmblodha edhe krijimtarinë e talenteve të reja të Skraparit dhe botova për here të pare almanakun letrar “Tomorri” në vitin 1971

Në vitin 1971 vura në skenë me punonjësit e shtypshkronjës dhe SMT premierën e teatrit me dramën e autorit Ramiz Likaj “Divorci” në takimin kombëtar të teatrove amatore, si regjisori, dhe fitova vendin e pare, ku u paraqita në takimin kombëtar

Në vitin 1980 u transferova në rrëthin e Vlorës dhe punova si mësues I gjuhës shqipe dhe I letërsisë në shkollë 8-vjeçare të Koculit, ku përvèç mësimdhënies u mora me veprimtaritë kulturore e artistike të shkollës dhe veprimtarive kulturore në shtëpinë e cultures të fshatit Kocul. Në kët periudhë bëra dhe studim toponomik përfshatin e Koculit.

Në vitin 1986 emërohem drejtor I shtëpisë së Kulturës Orikum, ku punova për 6 vjet rresht duke organizuar veprimtari të ndryshme kulturore dhe artistike, ku nga më kryesoret mund të përmendim:

Në Orikum

- Gjatë gjithë punës sime në shtëpinë e kulturës të qytetit të Orikut, përvèç shumë veprimtarive mund të pëmend disa prej tyre.

- Ngritura e ansamblit artistik i shtëpisë së kulturës
- Ngritura dhe organizimi i grupeve polifonike të zonës
- Organizimi dhe ngritura e grupit të estradës dhe të teatrit
- Organizimi i pesë festivaleve të këngës të muzikës së lehtë
- Festivale të interpretuesve me këngëtarë vendas
- Organizimi dhe ngritura e të parës ekspozitë me gjetjet arkeologjike në qytetin antik të Orikut dhe shumë veprimtari të tjera kulturore, artistike.
- Në vitin 1989, në kuadër të 45-vjetorit të çlirimtë të Atdheut Shtëpia e Kulturës Orikum shpallet si instituciomi më i mirë në rrëthin e Vlorës.
- Në vitin 1992 tranfesohejmë në Vlorë si drejtor i Pallatit të Kulturës Vlorë dhe në vitin 1995, si drejtor i Qendër Kulturore Vlorë.

- **Në Vlorë** Janë veprimtari të panumërtë:

Nga më kyesoret mund të përmenden:

- Organizimi i Miss-it të parë në qytetin e Vlorës

në vitin 1993, më pas ai i vitit 1999

- Festivali i këngës i muzikës së lehtë për të rritur në vitin 1993, 1994
- Organizim i përvitshëm i sofrës vlonjate në çdo fundviti.
- Grupet teatrore, takime të ndryshme dhe shumë veprimtari të tjera që duhen kohë për të shkruar për to.
- Pjesëmarrës si redaktor tekstesh në FFK

Gjirokastër 1988

- Organizator dhe drejtor i grupit të Vlorës në FFK Berat në vitin 1995
- Pjesëmarrës në ekspeditën folklorike, organizuar nga Institut i Folklorit Tiranë në vitin 1996 në zonën e Bregut të Detit.

- Organizator dhe drejtues në pjesëmarrjen dhe fitues çmimesh ne Festivalet e këngës qytetare, organizuar në Elbasan, duke filluar ngaviti 1996 e në vazhdim.

- Organizator dhe drejtues i grupit të Vlorës në FFK Gjirokastër në vitin 2000, fitues i çmimit të pare dhe që nga vitit 1988 e deri në festivalin e fundit të vitit 2023 në Gjirokastër, kam qenë gjithmonë në grupin e punës duke dhënë kontributin tim si organizator dhe folklorist..

- Pjesëmarrës në Folkloriadën e Parë Botërore në Holandë në vitin 1996.
- Drejtor organizator i grupit të Vlorës në pjesëmarrjen dhe fitues çmimesh në Festivalet e Fyellit Magjik, në Butrint Sarandë.

- Udhëhëqës artistik i koncertit qeveritar, organizuar me rastin e 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë Kombëtare, në datën 27 nëntor 2012 dhe - koncertit të datës 28 Nëntor 2012.
- Drejtor organizator që nga festivali i parë Vlorën “ - i Aulona Internacional Folk Festival, nga edicioni i parë deri në edicionin e fundit të vitin 2024..

Puna në QKF Vlorë

- QKF-ja kur kam marrë detyrën e drejtorit në vitin 2004 numëronte 3 tavolina dhe 3 karrike.
- U plotësua me 150 karrike dhe 30 tavolina 5 kompjutera me gjithë tavolina dhe kur u shkarkova në vitin 2008 u dorëzuan 149 karrike.
- U pajis me instrumenta, si një piano, tre fizarmonika, tastjerë (organo)tre kitara, dy klarineta, violina, fotokopje, telefon fax.
- U pajis me energji elektrike që deri atëhere nuk kishte.
- Nga QKF e kategorisë së dytë u kthye në QKF e kategorisë së parë me 5 sektorë, siç duhej dhe me sale shfaqjesh e skenë. U pajis salla me perde dhe të gjitha minimale çfarë duhej.
- Nga pesë veta në organikë, u plotësua me dhjetë veta siç e kërkonte rregullorja.
- U hartua plani vjetor i veprimtarive kalendarike që deri atëhere nuk ekzistonte fare, pra QKF u vu në pozita pune, sipas rregullores në fuqi.
- Nisën aktivitetet, nisi dhe pjesëmarria në veprimtaritë kombëtare dhe mbarëkombëtare. Në këtë mënyrë QKF Vlorë, filloi të njihet si institucion me homologët e saj dhe bëri emër të mirë.
- U sistemua gjithë dokumentacioni ekzistues dhe vjetorët sipas viteve.
- Gjatë kohës që isha në drejtim të institucionit të QKF Vlorë u bë një riorganizim i përgjithshëm i gjithë punës në të gjithë sektorët, në mbështetje të Rregullores së QKF-ve, gjë që kishte vite që nuk funksiononte, me një fjalë u ngrit gjithë puna, ashtu siç duhej të funksiononte një QKF sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi, punë, e cila vazhdon edhe sot.
- Aktivitetet nisën të zgjoheshin. Për të parën herë, në vitin 2005, u organizua Festivali i parë Mbarëkombëtar i këngës qytetare përfshirë fëmijë.
- Pjesëmarja e QKF Vlorë në të gjitha veprimtaritë kombëtare dhe mbarëkombëtare. Me një fjalë duhet thënë se nën drejtimin tim ndryshoi faqja e përgjumur e këtij institucioni dhe u radhit ndër më të mirat në rang Republike me një imazh krejt të ri në të gjitha drejtimet deri në binjakëzim me institucionin e tillë jashtë shtetit, siç është rasti i binjakëzimit me qytetin e Ohrit. Është puna që flet vet, e tëra e dokumentuar.
- Nga viti 2004 e deri në vitin 2008 u arrit deri në Festivalin e 34-të këngës përfshirë fëmijë.
- Për tre vjet rresht u organizua një konkurs gjithëpërfshirës, i cili ishte një risi përfshirë fëmijët e këtij institucionit që dha një rezultat shumë pozitiv dhe u pëlqye nga të gjithë aktorët pjesëmarrës.
- Një risi tjetër në QKF ishin edhe audicionet e zhvilluara përfshirë fëmijët e talenteve të reja në fusha të ndryshme të artit.
- U rrit numri i veprimtarive nga muaj në muaj.
- Mbrëmjet e Vitit të Ri pësuan një risi tjetër, u

gjerua në hapësirë dhe cilësi.

- Në të gjitha veprimtaritë, qoftë madhore, apo dhe të tjera u rritën shumë cilësisht.
- Në draft rregulloren që hartozi Ministria e Arsimit dhe Sportit për Qendrat Kulturore të Fëmijëve, pjesëtar i këtij grupi pune isha edhe unë, gjë një pjesë u pasqyrua edhe në Udhëzimin Nr. 44, datë 16.10.2014 “ Për normat mësimore.....”
- Për punën e mirë që kam kryer me fëmijët më është dhënë edhe titulli “ Mik i fëmijëve ” nga QKF Durrës.
- Si krijues mund të kem shkruar mbi 300 librete për veprimtari të ndryshme dhe montazhe letrare për veprimtaritë e organizuara në QKF Vlorë.

Krijimtaria letrare

Kam filluar të shkruaj që në klasën e katër të shkollës 7-vjeçare.

Botimet janë këto:

Vëllimi poetik “ Nesër ” – 1996

Vëllimi poetik “ Një emër, një firmë ” – 1998

Vëllimin poetik “ Natën vonë ” – 2001

Vëllimi poetik “ Ti më mungon ” – 2003

Studimin folkloric “ Festivali Folklorik Kombëtar për Vlorën ” – 2004

Studimin folklorik “ Vlora nëpër festival ” – 2018

Kam përgatitur për botim studimin folklorik “ Vlora nëpër festival ” – botim I dytë I ripunuar.

Studimin historic “ Palasa – sa ahër dhe sa larg ” – 2020

“ Kultura shpirtërore për fshatin Palasë ” – 2021

Vëllimin poeti “ Lotët – fjalë që duhen shkruar ” – 2004

Si krijues me përvojë në letërsi, kam redakruar dhe korrektuar për talentet e reja rrëth 30 libra të ndryshme

Kam përgatitur dhe botuar me krijimtarinë letrare të nxënësve të shkollës “ Lef Sallata ” “ Vlorë tre almanakë ” “ Zogj në fluturim 1, 2 dhe 3 ”


Këto ishin disa nga veprimtaritë kryesore të organizuara nga unë si specialist dhe drejtues kulture kudo që kam punuar dhe vazhdoj të jape kontributin tim për problemet e cultures në të gjitha drejtimet.



VASIL ÇUNI

Vepra dhe krijmtaria

[Redacted contact information]




VASIL CUNI

Portreti im është shum planësh, me një kontribut shumfishtë : Si një mësues , mjeshtër kori ,si krijues , si orkestrees dhe si dirigjent dhe të gjitha kanë rezultuar te sukseshme dhe frytdhënëse.

Krijmtaria ime ka shtrirje në shume qytete të tjera si në:Shkodër,Elbasan,Fier,Durrës,Tepelenë,Gjirokastër,duke përfshirë këtu tablotë muzikore për fëmijë, të rritur në konkurremin e shkollave te mesme, suitën për Orkestrën e Madhe Simfonike , këto veprimtari janë dalluar për një cilësi të lartë ekzekutimi.


Dëshira për të promovuar talentet e reja në qytetin e Vlorës më ka bërë që me punën e palodhur ti motivojë dhe nxis nxënësit për të ecur para dhe për të rritur aftësitë krijuese.Disa nga nxënësit e mi janë: Aurela Gaçe,Mariola Kaçani, Poni, Josif Glipali,Dhimitraq Furxhi, Sokol Toto,Artan Shabani, Arđian Hila , Altin Llaka, Anita Bitri.



Vasil Cuni

Shkollimi

- I lindur në Vlorë në 1 Janar 1947. Mësimet e para I kam marr në shkollen "Nr.3".
- Ne vitin 1960 - 1965 kam mbaruar shkollen e mesme artistike "Jordan Misja ", Tirane ne degen "Teoritike".
- Në vitet 1966-1970 kam mbaruar Konservatorin e Lartë Shëtëror në Tiranë në degën "Kritike Muzike" ndryshe e quajtur Muzikologji.
- Nën dreitmin e kompozitorit, orkestreesit dhe kritikut Gjon Simonit kam mbrojtur diplomën me temën: "Një vështrim kritik të të gjithë veprimitarës së kompozitorit Tonin Arapi, duke u përqëndruar në koncertin për piano dhe orkester me tre kohë.
- Në universitet mora formimin e duhur në degën e muzikës , arsimit, për konsolidimin shkencor dhe atdhetar të shumë brezave të nxënësve si dhe iu përkushtova profesionit të mësuesit.



Vasil Cuni

Mësimdhënia & Punësimi

-Gjate kohës që isha student për 2 vjet kam dhënë mësim në Liceun Artistik dhe 1 vit kam punuar si pedagog në Konservatorin Shtetëror.

Disa nga studentët e mi gjatë kësaj kohe kanë qënë:


Aleksander Peci, Sokol Shupo dhe Sopranoja Shqipe Zani.

-Mbas mbarimit të shkollë së Lartë fillova punë në qytetin tim si mësues i pianos dhe i solfezhit në Shkollën "Naim Frashëri".

Eksperienca e fituar në Tiranë u fut në eficencë të nxënësve në shkollën "Naim Frashëri", dhe kjo solli rezultat

pasi nxënësit e dalë nga kjo shkollë vazhduan Institutin e Lartë të Arteve.

-Në vitet 1991-1993 kam punuar si Shef i Muzikës për Jugun në Pallatin e Kulturës Vlorë




Vasil Cuni

Nënësit e nxjerr në vite

-Një nga nxënesit qe dalloja ne kete periudhe ishte Ina Bisha e cila mbas mësimeve të para që mori prej mejeshkoi të ndiqte konservatorin në degën e pianos në Romë dhe më vonë krijoji një kuartet me të cilin jepte koncerthe në gjithë Europën.


-Po ashtu dy nga nënësit e mi të cilët kanë lë gjurmë në qytetin e Vlorës dhe në gjithë Shqipërinë janë : Aulon Naçi i cili njihet dhe në Europë si një kompozitor dhe pianist i shkëlqyer me një krijmtari unike dhe Enis Mullai i cili sot është pedagog në Universitetin e Arteve tirani dhe kompozitor me pjesmarje të lartë në Festivalet e Këngëve në Shqipëri



Vasil Cuni

Krijimtaria

- Fushë tietër e kontributit tim është krijmatria
- Kam marrë pjesë për herë të parë në Festivalin e 10-të Kombëtar të këngës në Radio Televizion me këngën "**Nga një tjetër Stine**".
- Gjithashtu pjesmarrës në festivalin e 11-të të këngës në Radio Televizion me këngën "**Një kujtim nga deti**"
- Në festivalin e 12-të të këngës me këngën "**Një vajzë**" me tekst te Robert Shvarts
- Në festivalin e 13-të me këngën "**Kur qyteti është në festë**"
- Në festivalin e 26-të me këngën "**Mes basmash plotë ngjyra**"
- Sot në fonotekën e Radio Televizionit Shqipetare janë mbi 20 këngë të kompozuara në anketat muzikore ku mund të përmendim :
 - 1 - "**Dashuri e Re**" me tekst te Fatmir Hysit dhe kënduar nga Fatma Zyberi
 - 2 - "**Këngë për Nënën**" kënduar nga Lilijana Kondakci, "**Perseri Shitator**" kënduar nga Kozma Dushi me tekst të autorit vlonjat Spiro Qirinxhi
 - "**Shëtitja e parë në pranverë**", "**Në Thellësi të Bjeshkëve**" këngë e cila u be 10 vjet sigla e anketës muzikore në Radio Tirana



Vasil Cuni

Dirigjent, Pianist & Udhëheqës Artistik

-Një drejtim tjetër i kontributit tim në skenat dhe spektaklet artistike ka qënë instrumenti i pianos .

Duke filluar që nga pjesmarria në Tavernën e Hotel "Dajti " në Tiranë

-Mësues pianoje në Shkollën e Muzikës

-Pianist I Orkestrës Simfonike në Festivalat e fëmijeve dhe të rriturve

-Orkestracionet e Festivalit të Interpretuesve të klasës punëtore që zhvillohej çdo vit në Elbasan mban emrin tim si Udhëheqës Artistik .


-Si udhëheqës artistik dhe si drejtues kam realizuar premierat në zonat rurale si festivalet dhe anketat në Novosel , Armen, Peshkepi, Mekat.

-Drejtimi artistik I koncertit recital që I bëra krijmatrisë së kompozitorit Reshat Osmani

-Përfaqësimi I Ansamblit "Labëria " në Eksisheir të

Turqisë , ku ansamblit tonë ju dha një çmim special.

-Dirigjent I Parë I Orkestrës Gjysëm Simfonike Profesioniste që u themelua ne vitin 1972 për herë të parë në qytetin e Vlorës.




Vasil Cuni

Drejtues Kori

-Një dreitim tjetër i kontributit tim si muzikant ka qënë udhëheqja artistikedhe drejtues kori i asambleve të shkollave të mesme dhe qëndrave të punës për vite me radhë, ku për performancën e tyre janë vlerësuar me flamuj dhe çmime të para si në gimnazin Ali Demi, Halim Xhelo dhe Shkolla Industriale po ashtu dhe në ndërmarrjet e veshjes artistike, Fabrika e cementos ..etj të cilat janë akoma në kujtesën e disa brezave me koncertet përfestat jubilare si dhe ato të Pavarsisë, të Çlirimtë Vlorës, të Festës së Drashovicës ku kori ishte përbëre me 200-300 veta.

-Kam bërë tre premiera në Shkollën e Muzikës me kolegët: "Nasto Papakromi dhe Istref Dobi të cilat u pritën jashtzakonisht mirë

-Gjithashtu nxënësit e kësaj shkolle kanë realizuar dy videoklipy në një nga stacionet televiziv te qyetit të Vlorës si një promovim i talenteve të reja.



Vasil Cuni

Tituj Nderi

Për të gjithë kontributin që kam dhënë në fusha të ndryshme të muzikës jam vlerësuar me titullin :

1- "*Mirnjojje e Qytetit të Vlorës*" me motivacionin intelektual i shquar, përfaques i denjë i shkollës së muzikës shqiptare dhe asaj vlonjate, në veçanti në skenat kombetare dhe ndërkombëtare pedagogut dhe mësuesit të mirnjojur të shkollës artistike, kompozitori të talentuar për kontributin e madh në orkestrën simfonike.

2- Dhe me kuadrin e 100 Vjetorit të Pavarsisë me është dhënë titull "*Mirënjojje e Qytetit të Vlorës*" për kontributin në vite .

